




KOMUNA  
**RAHOVEC**

REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Administratë të sërgjithshme  
Qendrëza za Opëlu Uretru

III- Nr. i prot. 10 MB 04.01.2023  
Br. prot. DL RAHOVEC - ORAHOVAC

JANAR - DHJETOR 2022

# RAPORTI VJETOR I PUNËS



## DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

Drejtoria për Shërbime Publike, në bazë të Statutit të Komunës së Rahovecit dhe rregulloreve në fuqi, Planit të Punës për vitin 2022, përkundër sfidave dhe vështirësive ka përfunduar me sukses një sërë projektesh dhe ka realizuar një mori aktivitetesh përgjatë kësaj periudhe njëvjeçare, në vazhdim DSHP ka raportuar në baza tremujore mbi thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese.

### Tremujori i parë: janar, shkurt, mars

- Gjatë kësaj periudhe janë kryer disa punë të intervenimeve emergjente,
- Kompanitë e kontraktuar nga Komuna e Rahovecit, janë kujdesur në menaxhimin sa më të mirë të mirëmbajtjes së rrugëve dimërore,
- Kemi pasur kërkesa në takim me donatoret; si, për zgjerimin e kamerave që përfshin fazën e dytë rrugën tranzite dhe fshatin Hoqë e Madhe, takime me donator Italian për panela solare, takime me donatorin JICA për reformat në menaxhim të mbeturinave,
- Është formuar nga kryetari grupei punues lidhur me draft planin për vlerësimin e rrezikut nga fatkeqësitet natyrore dhe fatkeqësitet tjera,
- Gjate kësaj periudhe me donatorin KFOR-it Italian, kemi përfunduar projektin për vendosjen e paneleve solare në palestrën sportive Mizahir Isma,
- Kemi filluar punën e përbashkët me drejtorinë e inspektoratit për të implementuar të gjitha kërkesat dhe të hyrat që mund rrjedhin nga hapësirat publike,
- Kanë filluar punimet në rrugën 4 korsi, lot 3, kompania Mendi-P,
- Po ashtu kanë filluar punimet në kontratën e rrugëve lokale, lot 1, kompania KAG-Asfalt, punimet janë duke u bërë në fshatin Reti e Poshtme,
- Është bërë pastrimi i deponisë legale të mbeturinave,
- Kanë filluar punimet në ndriçim publik në fshatin Hoqë e Vogël dhe Brestoc
- Kanë filluar punimet ne Drenoc, ne ndërtimin e rrugëve lokale, nga kompania H-Seferi,
- Kemi filluar punimet ne sanimin e një rruge ne fshatin Xerxe,
- Ka vazduar krasitja e drunjëve dekorativ ne qytet dhe ne disa fshatra nga kompanitë e kontraktuara,
- Kanë përfunduar punimet në shtrirjen e rrjetit të ujerave të zeza në dy lagje të fshatit Zoqisht, me gjatësi 350 metra dhe 230 metra, vazhdojnë punimet në Rahovec në lagjen e epërme,
- Është dërguar kërkesa e komunës se Rahovecit drejtuar KEDS-it per planin investiv dhe kërkesat e qytetareve për periudhën 2023-2028 nga ana e KEDS-it,
- Gjate kësaj periudhe eshte bere shpërndarja e 2000 kontejnerëve 120 L, janë bërë shpërndara sipas listës dhe kërkesës se Komunës së Rahovecit, pasi komuna jone ka qen fituese e grantit te performances ne mëdis te pastër,

### Tremujori i dytë: prill, maj, qershor

- Ka filluar puna në draftin e ri te dokumentit për mobilitet,
- Gjate kësaj periudhe janë zhvilluar aktivitete në punimet me ndërtimin e rrugëve lokale ne disa pozicione si ne llot 1, nga kompania KAG asfalt, punimet janë duke u zhvilluar në Krushë të Madhe, në Dejn janë në përfundim dy segmente, pastaj ne Drenoc, ne ndërtimin e rrugëve lokale, nga kompania H-Seferi, në 4 segmente rrugore, janë përfunduar të gjitha këto segmente, po ashtu Gashi Ing ka pasur aktivitete në Xërxe.
- Vizite studimore në Mal të Zi, i organizuar nga asociacioni i komunave të Kosovës dhe partneret GIZ Gjerman, në kuadër të menaxhimit të integruar të mbeturinave nga data 24 deri 27 maj,
- Kanë përfunduar punimet në ndërtimin e trotuareve ne fshatin Malësi e Vogël ne drejtim te Gexhes përgjatë rrugës rajonale.

### Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator

- Gjatë kësaj faze janë përfunduar konkurset për dy ndërmarrjet publike lokale, janë zgjedhur anëtaret e rinjë, një anëtar (1) i bordit për KRM Ekoregjonin dhe (4) anëtare të tjera për bordin e stacionit te autobusëve,
- Është lidhur marrëveshja me KRU Gjakoven për zgjidhjen e problemit me ujë te pijshëm ne fshatrat Vrajak dhe Bertatin,
- Është nënshkrua marrëveshja me Ministrinë e Infrastrukturës për rregullimin e rrugëve ne qytet,
- Është përfunduar shenjëzimi i rrugës një kahore në rrugën "Ibrahim Rugova" dhe "Xhafer Nurkasa", është vendos shtegu për bicikletë dhe trotuari,
- Është miratuar vendimi ne kuvendin komunal lidhur me planin e menaxhimit te mbeturinave,
- Janë përfunduar tabelat lidhur me PZHK dhe planin për Hartografi,
- Gjate kësaj periudhe ka pasur vërsime ne komunën tonë, ka pasur disa ndërhyrje në pastrim të rrugëve dhe kanaleve sipas nevojës, tashme siq e dini njësia e FSK-se ka bërë ndërhyrje në përrosken e fshatit në Fortesë, vlera e demit në infrastrukturë publike është **550,722.00 euro**, (shih raportin me nr. protokolli 4230 i dates 03.10.2022,
- Poashtu ka vazhduar projekti i ndërtimit të kanalave i fshatit Celine, kanalin e fshatit Sapniq po janë bere disa ndërhyrje edhe ne kanalin e fshatit Dejne.

## Tremujori i katërt: totor, nëntor, dhjetor

- Gjatë muajit shtator është përruuar ndriçimi publik në rrugën kryesor Brestoc-Hoqe Vogël mbi 2,5 km, po ashtu janë zëvendësua poqët e natriumit me ato led ne rrugën "Xhelal Hajda" në Rahovec,
- Janë eliminuar deponite ilegale ne rrugën rajonale Rahovec-Suharekë si dhe në rrugën transite, po ashtu janë bërë edhe mbrojtë të vendeve për mos hudhjen e tyre,
- Ka përfunduar një segment i rrugës ne fshatin Nagac si dhe ndërtimi i një pjese të trotuarit,
- Është miratuar në kuvendin komunal plani për menaxhim të mbeturinave,
- Ka përfunduar projekti i ndërtimit të rrugëve lokale te komuniteteve ne lagjen e epërme dhe këndi i lojërave, ky investim është bashkëfinancim me MAPL, pjesa e grantit është financuar me 40,000.00 euro,
- Kanë filluar procedurat për dhenien e ankandit për deponine legale të mbetjeve inerte,
- Ne projektin e rrugës 4 korsi ka përfunduar shtresa e dyte e asfaltit ne rrugën 3 shiritore si pjesë e projektit të rrugës 4 korsi nga kompania Mendi-P, kompania Euroasfalt ka filluar punën në vendosjen e kanalizimit të ujërave të zeza dhe atyre atmosferike,
- Është lidhur kontrata për rrugë në qytet, sipas planit pritet të fillon puna shpejt, në rrugën "Fahredin Hoxha" dhe "Ali Sokoli",
- Janë duke vazhduar punimet në perroskën e fshatit Sapniq.

## Statistika;

1. Ndërtimi i rrugëve,
2. Ndërtimi i trotuareve,
3. Ndriçimi publik,
4. Rrjeti i ujërave të zeza,
5. Rrjeti i ujërave atmosferik,
6. Mirëmbajtja e hapësirave publike,
7. Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuarëve,

- ➡ **Sa i përket projektit të ndërtimit të rrugëve lokale, në vitin 2022, ka pasur aktivitete në këto vendbanime (Rahovec, Brestoc, Reti e Ulët, Nagac, Krushe e Madhe, Celinë, Xerxë, Sapniq, Patqan i Poshtëm, Drenoc) sipas projektit LOT 1, 2, 3 janë përfunduar, 34 rrugë me gjatësi 6589 metra (12589 m<sup>2</sup> elemente betoni),**
- ➡ **Rrjeti i kanalizimeve në vitin 2022; janë realizuar me gjatësi 1653 metra (me diametër Fi 250 dhe 315), ne Drenoc 343 metra, Rahovec 200 metra, Xerxe 200 metra, Kramavik 140 metra, Nagavc 200 metra, Zoqisht 570 metra.**
- ➡ **Projekti i ndërtimit të 6 segmenteve rrugore në qytetin e Rahovcit, përshtatje; 4240 metra kanalizim (Fi 630,400,315 dhe 250 fekal dhe atmosferik) si dhe 5526 metra rruge te asfaltuar, projekt i kontraktuar në nëntor te vitit 2022,**

- ↳ Projekti i ndriçimit publik, sivjet janë përfunduar 2.5 km ndriçim ne fshatrat Hoqe e Vogel dhe Brestoc, jemi ne proces te digjitalizimit te rrjetit te ndriçimit publik( total janë te mbuluar me ndriçim publik ( 23 vendbanime janë te mbuluar me ndriçim publik kane mbet edhe 9 per te përfunduar ne tersi), janë gjithsej 4273 poqa, ne total i bie 128 km rruge te ndriquara,
- ↳ Mirëmbajtja e rrugëve gjate dy sezonave (pastrimi bores dhe larja e rrugëve gjate veres) përfshin 3 lote sipas kontratës, lot 1 ka 71 km rruge, lot 2 ka 192 km rruge si dhe lot 3 ka 68 km rruge, ne total 338 km rruge te mirëmbajtura,
- ↳ Mure mbrojtëse, 47 metra në lagje të qytetit, ne rrugën "Sabit Shabandula" dhe lagjen Vuqiterna,
- ↳ Ndërtimi i trotuareve, rruga Tafil Zyberaj 910 m, Malesi-Gexhë 600 m, Pastasel 1550 m, Senoc, 1500 m, Drenoc 1300 m, Krushe dhe Nagac 700 m, gjithsej 6550 metra gjatësi,

#### Sfidat e DSHP-së:

- Të adresuara kërkesa për rrjete të reja të kanalizimit, ndërtimit të rrugëve lokale, për rrugë dytësore dhe të pa kategorizuara;
- Kërkesa për mirëmbajtjen e përroskave dhe kanaleve që gjenden në vendbanime dhe në lagjet urbane;
- Vështësi në ekzekutim te punimeve nga O.E sipas inflacionit dhe ndërprerjeve të kontratave,
- Sfidë e radhës që vazhdimisht na ka përcjellur gjatë vitit 2022 janë mbeturinat e amvisërisë që fatkeqësisht hidhen kudo, vend e pa vend, ku krijojen deponi ilegale;
- Furnizimi me ujë të pijshëm për ato vende që ende nuk kanë ujë të pijshëm(Pastasel, Kaznik dhe Zatriq), si dhe faza e dyte e zgjirmit, lagaj e eperme ne Rahovec, Hoqe e Madhe, Zoqisht dhe Opterushe,
- Projekti i rrugës 4 korsi në vitin 2022 ka qen sfidë, është finalizuar vetëm një pjesë e asfaltimit të rrugës së UÇK-së pjesë e kontratës si LOT 3, ndërsa Lot 1 nuk ka pasur aktivitete dhe Lot 2 ka punuar pjeserisht në hyrje të qytetit në rrjetin e kanalizimit,
- Pas reshjeve të shumta gjatë muajve maj dhe qershori, sfidë mbetet trajtimi i ujërave atmosferikë në rrugët kryesore të qytetit;

#### Kërkesat dhe të hyrat në DSHP gjatë vitit 2022:

- Në Drejtorinë e Shërbimeve Publike janë adresuar mbi 320 kërkesa të ndryshme gjatë vitit 2022, 216 janë të apovuara, 86 të refuzuara, 9 kanë qenë në process, 6 te anuluara, 1 e pranuar dhe 2 janë pezulluar, të tjerat kanë të bëjnë me investimet publike nga operatorë të ndryshëm!
- DSHP gjatë vitit fiskal 2022 në planin financiar ka pasur të planifikuara 12,500.00 euro nga taksat, vazhdimi i lejeve, shfrytëzimi i pronës publike, qiraja nga objektet e përkohshme, qiraja në objekte publike si dhe të hyra tjera, deri në muajin nëntor 2022 janë mbledhur 9,369.85 euro (duke përjashtuar muajin dhjetor 2022).



Planet komunale tē hartuara nga grupi punues nē kuadër tē DSHP-së pér vitin 2022 janë;

- ❖ **Plani komunal pér menaxhim tē mbeturinave ( 5 vjeqar)**
- ❖ **Plani komunal i transportit rrugor lokal (5 vjeqar)**
- ❖ **Plani komunal i mobilitetit urban (5 vjeqar)**
- ❖ **Plani komunal pér vlersimin e rrezikut tē fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tē tjera (5 vjeqar)**

#### Performanca komunale-indikatorët nga DSHP



Gjithsej janë 19 fusha nē total tē përfshira si kritere nē përformancën komunale



8 fusha dhe 30 tregues janë nē Drejtorinë e Shërbimeve Publike



**Fusha 6; Menaxhimi i fatkeqësive,** nē vitin 2021 ka munguar plani i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, ndërsa nē vitin 2022 është përfunduar plani i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore, nē këtë pikë jane 2 tregues dhe me përfundimin e ketij plani kemi realizim tē 100 % tē kësaj fushe.

**Fusha 8; Hapësirat Publike,** janë 3 tregues, nē vitin 2021 qendron një perqindje prej (100, 64 dhe 31 %) ndërsa nē vitin 2022 kemi një rritje tē vogël nē përqindje nē krahasim me vitin 2021,

**Fusha 9; Infrastrukturë rrugore,** janë gjithsej nē këtë fushë 8 tregues, përmirësimë kemi nē shtigjet urbane tē bicikletave, është rritur përqindja nē krahasim me vitin paraprak,

**Fusha 10; Transporti publik,** janë 3 tregues, nē vitin 2021 nuk kemi pasur plan tē transportit rrugor lokal, nē vitin 2022 ky plan është nē zbatim, nē këtë fushë kemi 100 %,

**Fusha 11; Parkingjet publike,** janë gjithsej 4 tregues me një realizim me mbi 51 % tē mbulueshmërisë, nē këtë fushë merret parasysh parkingjet nē raport me numirn e regjistimit veturave nē tërë komunën,

**Fusha 12; Uji i pijshëm,** 2 tregues janë gjithsej, ku komuna jonë mbulohet me 99.07 % tē mbulueshmërisë së territorit,

**Fusha 13; Kanalizimi,** nē këtë fushë janë gjithsej 3 tregues, dy tregues janë 100 % ndërsa treguesi i tretë që i përket impiantit tē ujërave tē zeza është i ngrirë pér shkak kostove tē mëdha që kanë këto projekte,

**Fusha 14; Menaxhimi i mbeturinave,** janë gjithsej 5 tregues nē këtë fushë, komuna jonë është duke realizuar nē tërsi planin nē menaxhim tē mbeturinave, sfidë mbetet taksa pér mbeturina që parashihet tē filloj nga viti 2024, ku pritet tē implementohet nē komunë si taksë.

## PËRFUNDIM

Ky raport përbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe reportuese.

- ➔ *Infrastrukturën publike,*
- ➔ *Sfidat dhe objektivat,*
- ➔ *Përfomancën komunale.*

Raporti i punës për vitin 2022 është dëshmi e respektit ndaj Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe i dedikohet të zgjedhurve nga qytetarët, monitoruesve dhe publikut të gjerë.

Mirëpresim kontributin e secilit që përmes vërejtjeve, këshillave, plotësimeve apo të dobësive eventuale, që t'i bëjmë bashkërisht përmirësimet e nevojshme, në mënyrë që në të ardhmen ta bëjmë përditë e më mirë punën tonë.

05.01.2023

Rahovec

PËRPARIM KRSNIQI

